Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Kreshnik Spahiu	**24.06.2024**	**05.07.2024**	**2024/0516**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 15.06.2024, OE "Prishtina Auto L.L.C." - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me numër: 2024/0516, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE " Ideal Shala B.I.:", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "FURNIZIM ME AUTOBUSA PËR POLICINË E KOSOVËS - Ritender 1" me numër të prokurimit: "214-23-10050-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS. AK ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 1,200,000.00€.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP- së, më numër 2023/0994 i datës 17.04.2024. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L- 068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

LPP i Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 1

Neni 4 pika 1.75

Neni 6

Neni 7

Neni 59

Neni 65 pika 1.3

RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Dosja e Tenderit (Numri i prokurimit: 214-23-10050-1-1-1)

Aneksi 6

Seksioni I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT

Përshtatshmëria e operatorëve ekonomik pika 6.1 nenpika C

Nenit 8 – Kriteret e përzgjidhjes pika 8.5 i udhëzuesit Nr. 001/2023.

Pretendimet akimore

Të nderuar,

Pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve bazuar në Nenin 108/A të LPP-së, ne, Operatori ekonomik "Prishtina Auto" L.L.C., pjesëmarrës në këtë aktivitet tenderik si palë e interesuar dhe i dëmtuar, parashtrojmë këtë ankesë për të dytën herë rradhazi në OSHP kundër vendimit të Autoritetit kontraktues Policia e Kosovës për aktivitetin tenderik me titull: "Furnizim me Autobusa për Policinë e Kosovës-Ritender1", me nr. të prokurimit: "214-23-10050-1-1-1".

Në vijim ju lutem na lejoni që ti prezentojmë pranë OSHP-së dëshmitë që haptazi konfirmojnë se edhe pas vendimit të OSHP-së me numër 2023/0994 të datës: 17.04.2024, AK ka bërë shkelje flagrante të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik që ne i prezentojmë në vijim:

1. AK me datë 02.05.2024 në kuptim të nenit 52.7 të LPP-së i drejtohet zyrtarisht me shkrim prodhuesit ku thekson, citoj:

On 07.11.2023, you issued a statement which says that it is from the manufacturer, please can you confirm the same to us, since in this statement there is no name of the responsible person and there is no signature.

Also, can you send us the manufacturers catalog (not a brochure) of the XML6121J bus model for which the statement states that it will be produced.

We thank you in advance and kindly ask that you reply as soon as possible.

Me date 07.05.2024, prodhuesi zyrtarisht i përgjigjet drejtpërdrejtë AK-së me deklaratë si në vijim, citoj:

Dear Sir :

We, Golden Dragon Bus as Manufacturer confirm that the documents you asked for are

VALID. and we fully support Kosovo Police via our distributor FroHan ApS regarding this procurement activity. Please find attached the documents and hereby we confirm that the busses will be produced and supplied according the Annex 1 - MANDATORY TECHNICAL SPECIFICATION.

Thank you !

Në vendimin e OSHP-së me numër 2024/0994 ndër tjerash theksohet, citoj:

me të drejtë eksperti shqyrtues ka konstatuar se katalogu i prodhuesit është dokument i cili vërtetohet se i njëjti ka ekzistuar edhe para hapjes se ofertave, sipas neni 10 iUdhëzuesit Nr.001/2023, për Prokurim Publik dhe me dispozitat e nenit 59 dhe 72 te LPP.Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues në kuptim të nenit 1, 6 dhe 7 të LPP, pretendimin ankimor ekualifikon si të bazuar dhe AK në fazën e ri-vlerësimit, në rast të dyshimit të deklarimeve dhe katalogjeve mund të fut në përdorim nenin 52.7 të LPP

2. AK haptazi nuk i është bind rekomandimeve të panelit shqyrtues të OSHP-së i cili në lëndën me numër të lartëcekur kjartë ka sqaru, citoj:

Paneli shqyrtues, pas administrimit të të gjitha provave dhe fakteve në këtë procedurë të prokurimi, sqaron se e mbështet konstatim e eksperti shqyrtues i cili gjatë shqyrtimit të kësaj çështje i është referuar drejtë dispozitave ligjore, për faktin parimor se në cilin do format kërkesa e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë lidhur me gjatësinë është e përmbushur dhe deklarata e prodhuesit e mbulon ankuesin duke i vërtetuar deklarimet e tij se ka ndodhur një gabim teknik dhe me të drejtë eksperti shqyrtues ka konstatuar se katalogu i prodhuesit është dokument i cili vërtetohet se i njëjti ka ekzistuar edhe para hapjes se ofertave, sipas neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023, për Prokurim Publik dhe me dispozitat e nenit 59 dhe 72 te LPP. Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues në kuptim të nenit 1, 6 dhe 7 të LPP, pretendimin ankimor e kualifikon si të bazuar dhe AK në fazën e ri-vlerësimit, në rast të dyshimit të deklarimeve dhe katalogjeve mund të fut në përdorim nenin 52.7 të LPP.

AK nuk e ka respektuar këtë sqarim të OSHP-së sepse me datë 29.05.2024, nëpërmjet dokumentit B58 njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues ku i njëjti na eliminon pa të drejtë nga ky aktivitet tenderik ndër tjerash në pikën 2 deklaron, citoj:

Ne ofertën e datës 19.10.20203 ka ofruar dimensionet e autobusit LxWxH 13340X2550X3700mm Ndërsa me sqarimet e datës 07 nëntor 2023 ka ofruar dimensionet :12340 X 2550 X3700mm me arsyetimin qe është bere gabim teknik nga prodhuesi ku edhe sjelle nje deklarate. Do te thotë ka ndryshim material i cili përcjellët me ndryshime te tjera.
Specifikacionet e ofruara nga OE te datës 19.10.2023

Overall Dimension	L×W×H: 13340 × 2550 x 3700 mm

Siç shihet kjartë, AK nuk e ka respektu sqarimin e dhënë të OSHP-së sepse i njejti deklaron se ka ndryshim materiali dhe kjo veçse është sqaruar nga OSHP prandaj si rezultat i kësaj, AK ka shkel Nenin 59 të LPP-së.

3. Se u shkel Neni 7 i LPP-së në mënyrë flagrante kjo nuk do koment. AK vazhdimisht na

diskriminon, nuk na trajton në mënyrë të barabartë me të tjerët dhe asesi nuk është transparent. Me të kuptuar që jemi eliminuar pa të drejtë nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në këtë aktivitet tenderik, neve kemi bërë kërkesë për çasje në dokumentacion me datë 30.05.2024. Çasja na është mundësuar në të njëjtën ditë dhe ne kemi pas dyshime se nuk është respektuar sqarimi i OSHP-së i lëndës numër 2023/0994 që thekson, citoj: *konstatohet pretendimi i Ankuesit se autorizimi përmban të meta , jo sa i përket validitetit, por sa i përket përmbajtjes sepse përmes autorizimit, prodhuesi është distancuar nga të gjitha përgjegjësit dhe jo vetëm për shërbimet pas shitjes dhe furnizimit me pjesë, por edhe nga trajnimet, gjë që kjo bie ndesh pastaj me obligimet e OE i cili mund të jetë fitues dhe është i obliguar që kërkesat e vendosura tek specifikimi teknik tju përmbahet dhe ti realizoj me rastin e implementimit të kontratës. Andaj, Paneli Shqyrtues konsideron se në kuptim të nenit 7, trajtimit të barabartë të palëve në këtë procedurë gjatë fazës së ri-vlerësimit të kërkohen nga AK sqarime shtesë edhe për OE të rekomanduar për kontratë se si mendon ta realizon këtë kontratë, qoftë edhe me deklaratë të prodhuesit, me qëllim që mos të vij deri tek më e keqja, siç është problemet në realizim të kontratës dhe/ose ndoshta dështimi i saj.*

AK me datë 02.05.2024 i drejtohet me shkrim OE të rekomanduar për kontratë ku thekson, citoj:

Ne dosjen e tenderit Aneksi I janë te paraqitura kushtet si:

2. . Kompania fituese është e obliguar që në momentin e nënshkrimit të kontratës të na furnizon me : "Aparatur për diagnostifikim kompjuterik dhe CD (katalogun /programin) për pjesë rezevë" për modelin e autobusëve ne fjalë.

Pajisja e kërkuar mund të jetë edhe një Llap top ku është i instaluar programi aktual , nuk kemi kërkuar përditësim të mëvonshëm të programit (kjo mund te behet ne baza vullnetare)

3. Kompania fituse është e obliguar që të bëjë trajnimin e së paku dy mekanikëve të autoritetit kontraktues.Obligative .

Ju lutemi te na e dërgoni një deklarate lidhur me kushtet si dhe te na ofroni sqarime se si do ta realizoni pikat sime lartë ?

OE i rekomanduar për kontratë me datë 06.05.2024 përgjigjet me shkrim si në vijim, citoj:

2. . Npsh Allmakes Global Services deklaron se nese kompania jone eshte fituese ne momentin e nënshkrimit te kontratës do te furnizoje me :"Aparature për diagnostifikim kompjuterik dhe CD(katalogun/programin)për pjesë rezervë" për modelin e autobusëve ne fjalë.
Paisja e kërkuar do te jete Llaptop ku eshte i instaluar programi ose diagnoze kompjuterike adekuate per modelin e ofruar .

3. Npsh Allmakes Global Services deklaron se nese kompania jone shpreblehet me kontrate per projektin ne fjale do te beje trajnimin e se paku dy mekanikeve te AK-Policia e Kosoves .

Te bashkangjitur i keni edhe deklaratat te cilat jane dorezuar me daten 19.10.2023

Edhe pse OE nëpërmjet sqarimeve shtesë përsëri dështon që të prezentojë atë se si mendon të realizojë këtë kontratë në pajtim me atë që ceket nga OSHP, qoftë edhe me deklaratë të prodhuesit, me qëllim që mos të vij deri tek më e keqja, siç është problemet në realizim të kontratës dhe/ose ndoshta dështimi i saj. Thjesht OE i rekomanduar për kontratë i ka bërë copy-paste deklaratat të cilat i ka dorëzuar me datën 19.10.2023, prandaj i njëjti nuk i plotëson kushtet për të qenë i përgjegjshëm, për më tepër, AK nuk ka shancë që të anashkalojë Nenin 1 të LPP-së dhe Aneksin 6 të DT-së që thekson kjartë se kriteret për dhënie të kontratës është çmimi më i ulët që në këtë rast është kompania jonë Prishtina Auto L.L.C.

4. Ne mbetemi mrapa pretendimeve tona të cekura në ankesën e datës 03.12.2023, respektivisht pika VIII që kemi deklaruar se arsyeja se përse tentohet nga AK që kompania jonë të eliminohet pa të drejtë nga pjesëmarrja në këtë aktivitet tenderik shpie si pasojë e ndikimit të personave zyrtar pranë AK-së që i njëjti aktivitet tenderik ti shpërblehet për dhënie të kontratës një OE i cili ka lidhje familjare me personin zyrtar të Policisë së Kosovës më saktësisht me drejtorin e prokurimit, prandaj kemi pasur edhe në të kaluarën dëshmi që personi zyrtar në fjalë ka qenë i përfshirë në konflikt-interesi. Sipas OSHP-së, citoj: *Edhe pse pas shikimit të shkresave AK në përgjigje ndaj raportit të ekspertit shqyrtues ka njoftuar OSHP se personi në fjalë ishte tërhequr nga zhvillimi dhe vlerësimi i kësaj procedure të prokurimit.*

Në dokumentin B58, njoftimin për vendimin e autoritetit kontraktues, ku jemi njoftuar që jemi eliminuar nga pjesëmarrja në aktivitetin tenderik në fjalë, është pikërisht i njëjti person që ka lidhje familjare me OE të rekomanduar për kontratë dhe i njëjti zyrtar ka qenë edhe paraprakisht i përfshirë në këtë vendim, shikoje në vijim:

Policia e Kosovës shpërblen me kontratë OE" Ideal Shala "B.I. Parku i Biznesit Drenas, Drenas
në vlerë totale 1,188,850.00€

Data: 29.05.2024

Emri dhe mbiemri i ZPP: Për ARTAN ROSTA

Ne pajtohemi me sqarimin e OSHP-së i cili thekson, citoj:

Ne do të bëjmë të pamundurën që të gjithë ata persona zyrtar të cilët kanë qenë dhe janë të implikuar në këtë aferë korruptive e ku si pasojë e kanë dëmtu rëndë kompaninë tonë, të japin përgjegjësi tek organet kompetente që janë mbikëqyrëse të Ligjit 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe se në rastin në fjalë do të mirret edhe IPK-ja.

Në vazhdim ju lutem na lejoni që ti sqarojmë edhe pretendimet e pabaza të AK-së që ndërlidhen me vendimin për refuzim për rishqyrtim të datës 06.06.2024 që AK pa të drejtë e klasifikon kërkesën tonë për rishqyrtim si të pabazuar. Në vazhdim ju prezentojmë faktet.

AK në dokumentin në fjalë deklaron:

Pretendimet se AK ka shkelur nenin 1 Qëllimi të LPP-ës , nuk qëndron pasi AK, sqaron se në mënyre me të drejt dhe efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, duke publikuar njoftimin për kontrate me procedure te hapur duke mos diskriminuar ose favorizuar asnjë OE, për këtë aktivitet te prokurimit. AK ka siguruar integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kanë kryer aktivitetin të prokurimit dhe që vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim. Këta persona zyrtarë që kanë kryer aktivitetin e prokurimit, janë sjellë duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike duke iu përmbajtur rreptësishtë procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji. Komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin e ofertave konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate dhe ka rekomanduar për kontratë OE që i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate. Ndërsa Oferta e juaj është e pa përgjegjshme pasi që nuk i keni plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit, njoftimin për kontratë si dhe Aneksin 1 Specifikacionet teknike te detyrueshme. Pretendimi juaj është i pa bazuar.

Ne mbetemi mrapa pretendimeve dhe deklaratave tona se AK asesi nuk e ka respektuar Nenin 1 të LPP-së. Kjo për arsye të cekur në pikën 3 të lartëshënuar. Për më tepër, AK pa të drejtë merr vendim për dhënie të kontratës një OE i cili bazuar në pikën e lartëcekur me numer 3, nuk është i përgjegjshëm dhe nuk i plotëson kushtet siç AK pretendon. Në vazhdim, AK poashtu deklaron:

Ne lidhje me pretendimin se AK ka shkelur nenin 6 te LPP, nuk qëndron pasi AK, të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Ne këtë aktivitet te prokurimi Autoriteti kontraktues duke marre ne konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit fondet publike i ka përdorë ne mënyrën ekonomike pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate i ka plotësuar te gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit si Tender i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, ndërsa oferta e Juaj nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara ne dosjen e tenderit, njoftimin për kontrate dhe specifikacionet teknike te detyrueshme prandaj, oferta e Juaj është eliminuar si ofertë e pa përgjegjshme. Pretendimi juaj është i pa bazuar.

Se është shkelur Neni 6 i LPP-së, kjo nuk diskutohet sepse haptazi është shkelur Neni 6 dhe jo vetëm. AK nuk deklaron të vërtetën sepse i njëjti nuk i shfrytëzon mjetet publike në mënyrën më ekonomike dhe transparente sepse bazuar në raportin e hapjës së tenderit rezulton se operatori ekonomik "Prishtina Auto" L.L.C., është ajo me çmimin më të ulët dhe poashtu i përgjegjshëm.

Deklarata e AK-së në vijim:

Pretendimet se AK ka shkelur nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veproj ë në mënyrë transparente, ku të gjithë Operatoret Ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktiviteti i ka trajtuar të barabartë. Po ashtu AK, sqaron se gjatë udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë: vi) që tenderi i zgjedhur te përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse pasi që oferta e rekomanduar për kontrate i plotëson te gjitha kriteret e kërkuara ne dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate. Andaj, Komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin e ofertave konform kërkesave të dosjes së tenderit, njoftimit për kontrate, specifikacioneve teknike te detyrueshme të kërkuara ne dosjen e tenderit Aneksi 1 si dhe ka rekomanduar për kontratë OE që i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Andaj, komisioni i vlerësimit te ofertave te gjithë ofertuesit duke ju përfshirë edhe juve si ankues ju kanë trajtuar te barabartë dhe nuk ju kanë diskriminuar sipas LPP-së. Andaj, oferta e juaj është e pa përgjegjshme pasi që nuk i keni plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit Aneksin 1 Specifikacionet teknike te detyrueshme. Pretendimi juaj është i pa bazuar.

Nuk qëndron sepse gjatë tërë ecurisë së këtij aktiviteti tenderik kemi pasur diskriminim, jo trajtim të barabartë me OE tjerë pjesëmarrës dhe asesi nuk ka pas transparencë nga AK. Për më tepër, Aneksi 1, specifikacionet teknike te detyrueshme janë 100% të plotësuara nga prodhuesi ynë, kjo është vërtetu gjithnjë nga prodhuesi ynë dhe sëfundi është konfirmuar përsëri me shkrim përmes shkreses zyrtare nga vet prodhuesi drejtuar AK-së me datë 07.05.2024. (Dëshmitë i gjeni të bashkangjitur me ankesë). Prandaj pretendimet e AK-së janë të pabaza dhe jo profesionale marrë parasysh këtu se i njëjti anashkalon edhe sqarimin e OSHP-së i cili kjartë është deklaruar në lidhje me këtë pretendim.

Pretendimi i rradhës i AK-së:

Pretendimet se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që vlerësimi i ofertave është bërë në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik, konforme kritereve te kërkuara në dosjen e tenderit, njoftimin për kontrate, specifikacioneve teknike te detyrueshme dhe ka rekomanduar për kontratë OE që i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit, njoftimin për kontratë duke rekomanduar OE si Tender i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët. Andaj, oferta e juaj nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara ne dosjen e tenderit, njoftimin për kontrate dhe specifikacionet teknike te detyrueshme prandaj, oferta e Juaj është eliminuar si ofertë e pa përgjegjshme. Ne vijim do të keni përgjigjet lidhur me pretendimet e juaj.

Nuk qëndron asesi sepse haptazi është shkelur Neni 59 i LPP-së dhe kjo haptazi shihet.

AK pa të drejtë na ka eliminu nga ky aktivitet tenderik dhe pa të drejtë merr vendim për dhënie të kontratës nje OE i cili bazuar në pikën e lartëcekur 3 nuk është i përgjegjshëm.

Pretendimi i rradhës i AK-së:

1. Sa i preket pretendimit ne piken 1 ne nuk pajtohemi sepse ju ofrojmë dëshminë se ne ofertën e dorëzuar me date 19/10/2023 ju keni dorëzuar specifikacionet teknike si ne vijim

1	Color type : White/Metallic gray color is allowed - equivalent to the metallic gray color of the patrol cars.	Compliant; White/Metallic	

Pas kërkesës per sqarimet ju me date 08/11/2023 jeni përgjigjur duke ngarkuar ne Eprokurimi përgjigjet si dëshmi/dokument si me poshtë

Bus Color	White

Nga fotoja e sipërme shihet e qarte qe ju me katalog e keni ofruar vetëm ngjyrën e bardh ndërsa ndërsa ne specifikcionin teknike te ofruar nga ju me datën 19/10/2023 ju keni bere ndryshim te ngjyrës se është ndryshim material pasi qe është kërkuar *Llojii I ngjyresë: E bardhë/ngjyra e hirit metalike – ekuivalente me ngjyrën e hirit metalike qe posedojnë veturat patrulluese.*

Nuk qëndron asesi sepse ne nuk e kemi ndryshuar asnjëherë ngjyrën. Në cilëndo kërkesë për sqarime qoftë me date 08/11/2023 apo 19/10/2023 gjindet ngjyra e njejtë e bardhë/White. Për më tepër, sa i përket këtij pretendimi të pabazë, ne kemi kërkuar nga AK që të na nënvizojë me fakte se ku kemi deklaruar që e kemi cekur ngjyrën e hirit ashtu siç i njejti ka pretendu se e kemi bërë, për këtë nuk ka dhënë përgjigje asnjëherë. Poashtu vlen të cekët se përse këtë pretendim dhe ato tjerat në vijim asnjë nuk i ka potencu kur është ballafaqu me OSHP-në gjatë fazes shqyrtuese të lëndës me numër 2024/0994 mirëpo tani tenton që të kategorizojë ofertën tonë si të papërgjegjshëm duke vepruar me shpifje të niveleve të ulëta kinse nuk jemi të përgjegjshëm, kjo sjellje e AK-së është përkeqardhje!. Sa i përket pretendimit të rradhës si në vijim:

2. Ne ofertën e dorëzuar me datën 19.10.20203 ju keni ofruar dimensionet e autobusit LxWxH 13340x2550x3700mm siaps aneksit 1 te specifikacionet teknike si me poshtë

6	Length (m): min 9,150	Compliant; 13340 mm

si dhe sipas katalogut si ne vijim

Overall Dimension	L×W×H: 13340 × 2550 x 3700 mm

Ndërsa gjate fazës se vlerësimit te ofertave është kërkuar sqarime shtesë dhe ne përgjigjet e ngarkuara nga ana e juaj me datë 08/11/2023, është vërejtur qe keni bere ndryshimin e dimensionit te gjatesise për pozicionin nr. 6 te aneksi 1 i specifikacioneve teknike si ne vijim;

6	Length (m): min 9,150	Compliant; 12340 mm

si dhe sipas katalogut si ne vijim

General Data / Dimensions / Chassis

Length/Width/Height (mm)	12340 mm x 2550 mm x 3700 mm

Nga fotoja e sipërme shihet e qarte qe ju me specifikacionet teknike aneksi 1 dhe ne katalog keni ofruar me dimensione LxWxH 13340x2550x3700mm ndërsa pas sqarimeve shtese keni ofruar 12340 X 2550 X3700mm te përshkruara ne specifikacionin teknike Aneksi 1 si dhe ne katalog andaj ju keni bere ndryshim ne gjatësinë e autobusit qe është ndryshim material.

Ky pretendim është tërësisht e pabazuar, ju lutem referoju pikës së lartëshënuar numer 2. Nuk kemi çfarë të deklarohemi në këtë rast, OSHP e ka dhënë fjalën e fundit në lidhje me këtë pretendim të pabazuar të AK-së i cili edhe shihet kjartë që nuk i bindet fare sqarimit dhe vendimit të OSHP-së.

Në lidhje me pretendimin e AK-së në vijim:

3. Pozicioni 13 Sipas Aneksit 1 specifikacionet teknike te detyrueshme te DT është kërkuar

Modelit I ndërruesit: manual ose automatik(3 vite garancinë)
Ne ofertën e juaj te dorëzuar me datë 19.10.20203 keni ofruar si ne vijim

Transmission	ZF 6 gears automatic

Ndërsa pas kërkesë për sqarime shtese ju keni ngarkuar ne eprokurim përgjigjet me datën 08/11/2023 duke ofruar katalogun si ne vijim

Transmission	Automatic shift gear

Nga fotoja e sipërme shihet e qarte qe ju me specifikacionet teknike aneksi 1 dhe ne katalog keni ofruar ZF 6 gear automatic ndërsa pas sqarimeve shtese keni ofruar Automatik shift gear andaj ju keni bere ndryshim ne transmisionit qe është ndryshim material.

Nuk është e vërtetë që ne kemi bërë ndryshim material. Kjo nuk pranohet në asnjë mënyrë. Kriteri në fjalë gjithmonë është ofruar i njejtë. Ne kemi ofruar ndërrues të shpejtësisë në përputhje të plotë me Aneksin 1 të DT i cili është ndërrues automatik dhe kjo mbetet gjithmonë dhe nuk ndryshon asnjëherë prandaj pretendimi juaj është totalisht i pabazuar.

Pretendimi tjetër i rradhës i AK-së në vijim:

4. Pozicioni 19 sipas Aneksit 1 specifikacionet teknike te detyrueshme te DT është kërkuar Sistemi I drejtimit: Servo Hidraulik

Ne ofertën e juaj te dorëzuar me datë 19.10.20203 ju keni ofruar si ne vijim

Steering system	Bosch Power steering

do te thotë qe keni ofruar Timon me energji elektrike

Ndërsa pas kërkesë për sqarime shtese ju keni ngarkuar ne eprokurim përgjigjet me datën 08/11/2023 duke ofruar katalogun si ne vijim

Hydraulic system	Servo hydraulic system fitted

Nga kjo shihet se keni ofruar Servo Hidraulik

Nga fotoja e sipërme shihet e qarte qe ju me specifikacionet teknike aneksi 1 dhe ne katalog keni ofruar Bosch Power steering ndërsa pas sqarimeve shtese keni ofruar Servo Hydraullic system fitted andaj ju keni bere ndryshim ne hydralik system qe është ndryshim material.

Është i pabazuar sepse nuk ka pas asnjëherë dhe as që kemi ndryshim material edhe tani. Kjo sepse gjithnjë edhe para hapjës së tenderit edhe pas sqarimeve shtesë ka qenë specifika e njejtë. Ne kemi aplikuar me timon servo i sistemit hidraulik në përputhje me Aneksin 1 të DT. Kështu ka qenë dhe kështu do të mbetet prandaj nuk është e vërtetë që kemi ndryshim material këtu, kjo është pretendim i nivelit të ulët dhe për keqardhje se si tenton AK të manipulojë me këto pretendime.

Sa i përket pretendimit në vazhdim:

5. Pozicioni 15-16 është kërkuar ne Aneksin 1 te specifikave teknike te detyrueshme te DT si me poshtë

15.Sistemi I amortizimit për aksin e parë duhet të jetë me amortizator, dhe jastëk me ajër.

16.Sistemi I amortizimit për aksin e pasmë duhet të jetë me amortizator, dhe jastëk me ajër.

Ne ofertën e juaj te dorëzuar me date 19.10.2023 OE keni ofruar si me poshtë

Suspension	Air suspension for all axles

Ndërsa ne kërkesën për sqarime shtese te kërkuar me date 08.11.2023 OE ka ofruar si me poshtë

Front axle damping system shock absorber and airbags	fitted
Rear axle damping system shock absorber and airbags	fitted

Në katallogun e derguar te dates 07.11.2023 nuk deshmon qe sistemi i amortizimit duhet te jete me amortizator por vetem me ajer behet pezullimi andaj OE nuk e ploteson kete specifikacionet teknike te kerkuara ne Aneksin 1.

Është totalisht e pavërtetë që nku e plotësojmë këtë specifikacion teknik të kërkuar në Aneksin 1. Fitted i bije që kërkesa në fjalë është i pajisur me autobus dhe është qesharake pretendimi i AK-së sepse i njëjti edhe vet nuk e din se çfarë pretendon sepse jo që i mungon përvoja por me pretendime të tilla tenton të na cilësojë si të papërgjegjshëm, Nuk kemi çfarë të komentojmë më tepër për pretendime të tilla qesharake e joprofesionale. Në lidhje me pretendimin e AK-së në vijim:

6. Pozicioni 17 është kërkuar ne Aneksin 1te specifikave teknike te detyrueshme te DT është kërkuar Sistemi i frenimit: min ABS

Ne ofertën e juaj te dorëzuar me datë 19.10.20203 ne specifikacionin teknike aneksi 1 ju keni ofruar si ne vijim

17	Braking system: min ABS	Compliant

si dhe sipas katalogut si ne vijim

Brake system	Full disk brake with Wabco EBS

Ndërsa pas kërkesës për sqarime shtese ju keni ngarkuar në eprokurim përgjigjet me datën 08/11/2023 duke ofruar katalogun si në vijim

ABS / Anti-lock braking systems	Fitted

Nga fotoja e sipërme shihet e qarte qe ju prezantoni si ABS i inkorporuar dhe bëni ndryshimin nga EBS në ABS pas sqarimeve te kerkuara, andaj ju keni bere ndryshimin nga EBS ne ABS qe është ndryshim material.

E kemi bërë të qartë edhe paraprakisht në kërkesën për rishqyrtim se EBS dhe ABS janë një sistem dhe që të dyja bashkarisht janë të pajisura me autobus. Për të bindur AK-në me fakte sa i përket kësaj çështjeje, ne e kemi përfshirë edhe katallogun e prodhuesit të OE të rekomanduar për kontratë e cila shihet si në vijim:

Brake System	
Front / Rear	Disc / Disc
System	Full Air Brake System With ABS and EBS,

Nga kjo që shihet më lartë, konfirmohet kjartë ABS and EBS që do të thotë të ABS dhe EBS. Pothuajse te çdo autobus të dyja ofrohen si paisje standarde sepse kanë të bëjnë me siguri të frenimit dhe asesi nuk pranojmë dhe nuk është e vërtetë që kemi ndryshim materiali, edhe para hapjës së tenderit ka egzistu dokumenti i cili është i njejtë me atë që AK e cilëson në përgjigjet e datës 08.11.2023.

Po e potencojmë edhe pretendimin e rradhës të AK-së si në vijim:

7. Pozicioni 20 është kërkuar ne Aneksin 1te specifikave teknike te detyrueshme te DT është kërkuar - Pajisjet standarde minimale; Xhamat e dyfishtë, perdet, fellne standarte, mbrojtëset nga dielli para, ulësja ndihmëse, radio CD, mikrofonin për informimin e pasagjerëve, drita për mjegull, tepihat e dyshemesë, **paranxemje (vebstator),**

Në ofertën e juaj të dorëzuar me datë 19.10.20203 ne specifikacionin teknike aneksi 1 ju keni ofruar si ne vijim

20	Minimal standard equipment, , Double glazed windows, curtains, standard runs, sun protection in front, additional seat, Radio CD, microphone to inform passengers, fog lights, floor carpets, pre-heat.	Compliant

si dhe sipas katalogut si ne vijim

Heat system	Passenger heat system with 4 Radiators

Ndërsa pas kërkesës për sqarime shtese ju keni ngarkuar në eprokurim përgjigjet me datën 08/11/2023 duke ofruar katalogun si në vijim

Pre-Heater	Fitted

Do te thotë qe ju ne ofertën e juaj keni ofruar mundësi te nxehjes me radiator (4 radiator) po nuk keni ofruar para nxemjes ashtu siç është kërkuar ne Aneksin 1 specifikacionet teknike te detyrueshme ne kërkuara ne dosjen e tenderit.

Nuk pajtohemi me pretendimin e AK-së i cili deklaron se nuk kemi ofruar para nxemje që në treg quhet Webasto. Kjartë në Aneksin 1 theksohet me termin „Fitted" që do të thotë paisja në fjalë është i pajisur me autobus. Siç jemi deklaruar më lartë, si dëshmi dokumenti Aneksi 1 ka egzistuar edhe para hapjës së ofertave dhe vlen të theksohet poashtu që edhe prodhuesi ka deklaru qoftë edhe në deklarata të DT-së poashtu edhe në shkresa elektronike zyrtare se në tërësi përmbushet Aneksi 1 i DT-së. Por AK nuk i ka marr parasysh asnjëherë këto të dhëna dhe si pasojë e kësaj shkel Nenin 1 dhe 7-të të LPP së.

Në lidhje me pretendimin e AK-së:

Në katalogun si foto e ofruar nga ana e juaj vërehen disa elemente që bien ndesh me pretendimet e juaj si me poshtë:



Në foton e marr një pjese nga katalogu nuk ka dëshmi qe ky autobusë ka para nxemje por vetëm komandën e AC.

Ne deklarojmë se para nxemje i cilësuar si vebasto është sistem i ngrohjës i cili aktivizohet automatikisht kur kemi temperatura të ulëta si përshembull në stinën e dimrit. Në momente që temperaturat kalojnë -0 atëherë automatikisht aktivizohet sistemi në fjalë që mundëson që të kemi ngrohje paraprake. Për më tepër edhe në katallogun e prodhuesit të OE të rekomanduar për kontratë funksionon ngjajshëm vebasto si në çdo autobus tjetër prandaj pretendimi i AK-së është në tërësi i pabazuar.

Poashtu në lidhje me pretendimin në vijim:

Dëshmia egziston në broshurë, prodhuesi e cek që brendi i sistemit të klimatizimit është "Sutruck" e jo siç AK potencon "Songz". AK sigurisht që këtë e ka marrë nga ndonjë model i autobusit që nuk i përket modelit që ne e kemi ofertuar prandaj për të përmbyll këtë pretendim të pabazë i AK-së, ne ju themi se vet prodhuesi përmes shkresës zyrtare të drejtuar tek AK kur i njejti ka kërkuar verifikim të deklaratës së prodhuesit i cili ka deklaruar se dokumentet janë VALIDE dhe se përmbushet në tërësi Aneksi 1. Ju nuk mundeni të pretendoni diçka ndryshe nga ajo që realisht është e cekur nga vet prodhuesi në broshurë sepse ju nuk jeni prodhues por autoritet kontraktues prandaj ky pretendim është i pabazuar. Shto këtu faktin edhe se AK mundet të kërkojë konfirmim me shkrim drejtpërdrejt tek prodhuesi jo vetëm për këtë çështje por për çfarëdo që AK-së i intereson!. Pretendimi i rradhes i AK-së:

Ne foto te ofruar nga ju ne specifikcionin teknike keni deklaruar qe automjeti është automatik

13	Shift gear model: manual or automatic(3 years warranty)	Compliant; Automatic shift gear
Transmission	Automatic shift gear	

Ndërsa ne katalog ju e keni ofruar automjetin ndërruesin e shpejtësisë manual për me tepër Shih ne foto me poshtë

Sipas dëshmisë katalogut te dorëzuar pas sqarimeve shtese e ngarkuar ne eprokurim me datën 08/11/2023 fotoja e shkëputur nga ky katalog vërehet se ky autobus është manual ndërsa ne ofertën baze te datës keni theksuar se është autobus automatike andaj, ju keni bere ndryshim material. *Sipas nenit 59 pika 2 te LPP-se, Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. Andaj oferta juaj refuzohet pasi që kemi ndryshim materiali.* Po ashtu oferta e juaj është e pa përgjegjshme pasi qe nuk i plotëson specifikacionet teknike te detyrueshme ashtu siç janë kërkuar ne dosjen e tenderit Aneksi 1.

Në linjën 13 kjartë cekët që ndërruesi i shpejtësisë duhet të jetë Manual ose Automatik me 3 vite garancion. Ne kemi deklaruar se ofrojmë ndërrues të shpejtësisë Automatik. Kështu ka qenë në Aneksin 1 të DT-së para hapjës së ofertave dhe në çdo dokument të mundshëm është e njëjta vlerë pra automatik. Përpos fotos së cekur nga AK, në katallog është edhe foto e ndërruesit automatik por AK nuk e ka potencu edhe këtë fakt prandaj shikoje në vijim:

Asesi jo vetëm në këtë pretendim të AK-së por në ofertën tonë nuk ka ndryshim materiali përpos që ne e kemi paralajmëruar AK-në në lidhje me linjën numër 6 që ka pas gabim teknik

dhe për këtë edhe egziston vendimi i OSHP-së i cili e vulos këtë pretendim që ka pas gabim teknik shtypi dhe e ftojmë AK-në që të ndalet me këto deklarata jo të vërteta sepse çdo herë vetem po del ma jo serioz dhe jo profesional. Po e cekim pretendimin e fundit të AK-së:

Sa i përket pretendimin lidhur me sqarimin me OE të rekomanduar për kontrate nuk qëndron pasi që ne kemi kërkuar sqarime për te ri konfirmuar se si do te beje implementimin e kontratës per ikat qe janë pjese e Aneksit 1 te dosjes se tenderit. Pretendimi juaj është i pa bazuar.

Andaj Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve është bërë ne përputhje të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik dhe akteve tjera ligjore.

Është vërejtë kjartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë asnjë sqarim profesional se si do të implementojë kontratën në fjalë, siç kemi deklaru më lartë në pikën 3. Pretendimi i AK-së është i pabazuar dhe vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në asnjë mënyrë në përputhje të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik dhe akteve tjera ligjore përkundrazi AK në mënyrë flagrante e ka shkel LPP-në përfshirë aktet tjera ligjore. **Me nënshkrimin dhe vulosjën e deklaratës nën betim nga OE i rekomanduar për kontratë shpie drejt shkeljës së Nenit 8 – Kriteret e përzgjidhjes pika 8.5 i udhëzuesit Nr. 001/2023 për prokurimin publik.**

Ne kërkojmë nga OSHP që ti aprovojë kërkesat tona ligjore në vijim:

1. Të mirret përbazë lënda e OSHP-së me numër 2023/0994 e datës 17.04.2024.

2. Të hyjë në fuqi Neni 105 i LPP-së pika 2.16. që thotë, citoj:

Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata".

3. Kërkojmë nga OSHP që lënda në fjalë të kthehet në ri-vlerësim.

4. Kërkojmë nga OSHP që të fus në funksion pikën IV të vendimit të panelit shqyrtues që thekson, citoj:

Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

5. Kërkojmë nga OSHP poashtu që të jetësojë edhe pikën V të vendimit të panelit shqyrtues që thekson, citoj:

Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-42, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

Meqenëse pika e lartëcekur 3.4 dhe 3.5 kanë munguar në vendimin e OSHP-së me numër 2023/0994, ne kërkojmë nga OSHP-ja që përmes këtyre pikave në fjalë ta obligojë AK-në që

të raportojë Organin shqyrtues për të gjitha hapat e marra për këtë aktivitet tenderik në mënyrë që sëpari OSHP-ja të jetë në dijeni rreth të gjitha veprimeve që do të ndërmirren në të ardhmen nga AK sa i përket këtij aktiviteti tenderik.

KRITERET PËR VLERËSIM

Përshtatshmëria profesionale

- Kërkesa c) - Autorizimi nga prodhuesi ose Distributori i autorizuar i Prodhuesit për shitje(me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë, në kohëzgjatje të kontratës prej 36 muaj),
- Dëshmia c) - Autorizimi nga prodhuesi ose Distributori i autorizuar i Prodhuesit për shitje(me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë, në kohëzgjatje të kontratës prej 36 muaj)

Kapaciteti teknik dhe professional

- Kërkesa 1 - Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar te karakteristikave teknike, me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikacioneve teknike ofruara.
- Dëshmia 1. Katalog nga prodhuesi.

Aneksi 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit, negocim te ofertave per kete aktivitet i prokurimit, konstatojmë se për këtë projekt janë pranuar kater(4) oferta.

Dy (2) OE: Grup i Operatoreve Ekonomik PRICOM SH.P.K.; EMPREUS SH.P.K. dhe "KOSOVA MOTORS GROUP " SH.P.K. nuk kane here vazhdimin e vlefshmerise se tenderit dhe Sigurimit te ofertës andaj nuk janë trajtuar.

Komisioni vleresues rekomandon OE "Ideal Shala B.I"., sepse i ploteson te gjitha kriteret e kerkuara ne dosje te tenderit si dhe çmimi me i ulet si oferte e pergjegjshem.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Nuk ka.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP- së, më numër 2023/0994 i datës 17.04.2024.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" Prishtina Auto " L.L.C.**

Sqarim hyrës:

Parashtruesi i ankesës – (OE) "Prishtina Auto" L.L.C. (më tej OE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 02.06.2024, për të cilën AK me datë 06.06.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Eksperti ka shqyrtuar pretendimet ankimore të paraqitura që lidhen me shkeljen e dispozitave të LPP dhe RrPP. Ndërsa pretendimet ankimore në lidhje me konfliktin e interesit janë jashtë autorizimeve të Ekspertit dhe për këtë çështje në vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së 2023/0994 është udhëzuar OE ankues që çështjen ta adresojë në institucionet tjera kompetente.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 59 të LPP-së duke rekomanduar OE i cili është i papërgjegjshëm pasi që ka dështuar të përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit lidhur me Aparaturë për diagnostifikim kompjuterik dhe CD (katalogun /programin) për pjesë rezeve.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 1

AK, në dosjen e tenderit, tek Aneksi 1 Specifkimet teknike të detyrueshme, pas tabelës me specifikimet e produkteve, ka vendosur kërkesën "2. Kompania fituese është e obliguar që në momentin e nënshkrimit të kontratës të na furnizon me : "*Aparatur për diagnostifikim kompjuterik dhe CD (katalogun /programin) për pjesë rezevë" për modelin e autobusëve ne fjalë. Pajisja e kërkuar mund të jetë edhe një Llaptop ku është i instaluar programi aktual , nuk kemi kerjuar përditësim të mëvonshëm të programit (kjo mund te behet ne baza vullnetare)"*

OE i rekomanduar për kontratë në ofertë ka dorëzuar në lidhje me këtë kërkesë ka dorëzuar dokumentin "Deklaratë për aparaturë" në të cilën shënohet: "*Npsh Allmakes Global Services deklaron se nese kompaniajone eshte fituese ne momentin e nenshkrimit te kontrates dote furnizon me : "Aparatur per diagnostifikim kompjuterik dhe CD (katalogun /programin) per pjese rezeve" per modelin e autobuseve ne fjale. Pajisja e kerkuar dote jete Llaptop ku eshte i*

instaluar programi ose diagnoze kompjuterike adekuate per modelin e ofruar ." Gjithashtu është dorëzuar edhe dokumenti i emërtuar "Deklaratë për trajnimin e mekanikëve" në të cilin shënohet: "*Npsh Allmakes Global Services deklaron se nese kompaniajone shpreblehet me kontrate per_projektin ne fjale dote beje trajnimin e se paku dy mekanikeve te AK Policia e Kosoves*"

AK me datë 02.05.2024 përmes platformës eprokurimi ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar si vijon: "*Ne dosjen e tenderit Aneksi I janë të paraqitura kushtet si: 2. Kompania fituese është e obliguar që në momentin e nënshkrimit të kontratës të na furnizon me : "Aparaturë për diagnostikim kompjuterik dhe CD (katalogun /programin) për pjesë rezeve" për modelin e autobusëve ne fjalë. Pajisja e kërkuar mund të jetë edhe një Llaptop ku është i instaluar programi aktual, nuk kemi kërkuar përditësim të mëvonshëm të programit (kjo mund te behet ne baza vullnetare). 3.Kompania fituese është e obliguar që të bëjë trajnimin e së paku dy mekanikëve të autoritetit kontraktues. Obligative. Ju lutemi te na e dërgoni një deklarate lidhur me kushtet si dhe te na ofroni sqarime se si do ta realizoni pikat si me lartë? Andaj bazuar ne nenin 59 dhe 72 të LPP kërkoj nga ana juaj që të na dëshmoni sipas kërkesave të mësipërme. Përgjigjen e juaj sqaruese duhet ta ngarkoni në E-prokurim më së largu brenda 5 ditë deri në ora 16:00."*

OE i rekomanduar për kontratë, me datë 06.05.2024 kishte dërguar dokumentet sqaruese. Deklaratën me sqarime në të cilën shkruan: "*Sqarimi nga Npsh Allmakes Global Services si me poshte : Lidhur me sqarimin e kerkuar te dates 02.05.2024 Npsh AGS jep sqarim se per keresat e larte shenuar ne me rastin e dorezimit te ofertave me daten 19.10.2023 ne sis item in E-prokurim kemi dorzuar edhe Deklaraten per Aparaturen e autobusave si dhe deklaraten per trajnimin e mekanikeve te AK Policia e Kosoves. Andaj ne deklarojm dhe qendrjme mbrapa deklaratave tona si me poshtë: 2. Npsh Allmakes Global Services deklaron se nese kompania jone eshte fituese ne momentin e nenshkrimit te kontrates dote furnizoje me :"Aparature per diagnostifikim kompjuterik dhe CD(katalogun/programin)per pjese rezerve" per modelin e autobuseve ne fjale. Pajisja e kërkuar do te jete Llaptop ku është i instaluar programi ose diagnoze kompjuterike adekuate për modelin e ofruar. 3. Npsh Allmakes Global Services deklaron se nëse kompania jone shpërblehet me kontrate për projektin ne fjale do te beje trajnimin e se paku dy mekanikeve te AK-Policia e Kosovës. Te bashkangjitur i keni edhe deklaratat te cilat janë dorëzuar me datën 19.10.2023."*. Dokumentit të sqarimeve i janë bashkangjitur edhe deklaratat të dorëzuara me ofertë për aparaturë dhe trajnim.

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 1</u>

Eksperti sqaron se kërkesat e vendosura nga AK në dosjen e tenderit në mënyrën se si janë formuluar janë kërkesa të ekzekutimit me të cilat vihen në dijeni OE-të se në këtë aktivitet në momentin e nënshkrimit të kontratës OE i shpërblyer me kontratë të sjellë pajisjen për diagnostikim kompjuterik dhe CD (katalogun /programin) për pjesë rezervë si dhe të bëjë trajnimin e së paku dy mekanikëve të autoritetit kontraktues. Në këtë pikë AK nuk ka paraqitur ndonjë specifikim të veçantë si dhe nuk ka precizuar dëshmi për vlerësim. Andaj, deklaratat e OE të rekomanduar për kontratë janë dëshmi që e sigurojnë AK se OE zotohet që do ti kryej furnizimin dhe shërbimin e trajnimit. Eksperti vlerëson se konform nenit 56.3 të LPP, asnjë operator ekonomik nuk mund të eliminohet për ndonjë kërkesë e cila nuk është e vendosur në Dosje të Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, andaj AK ka vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP-së. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i pabazuar në këtë pikë.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 59 të LPP-së kur ka konstatuar se OE ankues është i papërgjegjshëm. Përkatësisht OE ankues pretendon se nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit të precizuara nga AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 2

AK me datë 29.05.2024 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së në të cilin rekomandohet për kontratë OE "Ideal Shala B.I.". Krahas vendimit është dërguar (publikuar) letra standarde për tenderuesin e eliminuar për OE ankues, në të cilën AK ka dhënë arsyetimin si vijon: *"Grup i Operatorëve Ekonomik Prishtina Auto L.L.C.; D & T Group SH.P.K. ka dështuar ne plotësimin e specifikacioneve teknike pasi qe me date me sqarime te date 07 nëntor 2023 ka bere ndryshim material ne disa nga specifikacionet e autobusit si: 1. Sipas Aneksit te DT Lloji I ngjyresë : E bardhë/ ngjyra e hirit metalike – ekuivalente me ngjyrën e hirit metalike qe posedojnë veturat patrulluese. Ne ofertën e dërguar te datës 19.10.2023 ne specifikacion e ka cekur qe është E bardhë/ ngjyra e hirit metalike por me sqarimet e datës 7 nëntor 2023 përmend vetëm qe është e bardhe. 2. Ne ofertën e datës 19.10.20203 ka ofruar dimensionet e autobusit LxWxH 13340X2550X3700mm. Ndërsa me sqarimet e datës 07 nëntor 2023 ka ofruar dimensionet :12340 X 2550 X3700mm me arsyetimin qe është bere gabim teknik nga prodhuesi ku edhe sjelle nje deklarate. Do te thotë ka ndryshim material i cili përcjellët me ndryshime te tjera.*

Specifikacionet e ofruara nga OE te datës 19.10.2023

Overall Dimension	L×W×H: 13340 × 2550 x 3700 mm

Sqarimet e datës 7 nëntor 2023

3. Please Note: In the last Annex 1 document Line 6, there was an error typing 13340. Instead of this, it must be 12340.

8. Pozicioni 13Sipas Aneksit te DT

Modelit I ndërruesit: manual ose automatik(3 vite garancinë)

OE me ofertën e datës 19.10.20203 ka ofruar ZF 6 ndërrues automatik te shpejtësish

Transmission	ZF 6 gears automatic

Transmission	Automatic shift gear

Me date 19.10.2023 OE nuk e ceke fare ZF 6

9. Pozicioni 19.

Ne Aneksin 1 Sistemi I drejtimit : Servo Hidraulik

OE ne ofertën e datës 19.10.20203 ka ofruar

Steering system	Bosch Power steering

Do te thotë qe ka ofruar Timon me energji elektrike

Ndërsa me date 07.11.2023 OE ka ofruar

Hydraulic system	Servo Hydraulic system fitted

Qe do te thot ka ofruar Servo Hidraulik

10. Pozicioni 15-16 i kërkuar ne Aneksin 1 te specifikave teknike te detyrueshme te DT si me poshtë

15.Sistemi I amortizimit për aksin e parë duhet të jetë me amortizator, dhe jastëk me ajër.

16.Sistemi I amortizimit për aksin e pasmë duhet të jetë me amortizator, dhe jastëk me ajër.

Ndërsa ne ofertën e dorëzuar me date 19.10.2023 OE ka ofruar si me poshtë

Suspension	Air suspension for all axles

Ndërsa ne kërkesën për sqarime shtese te kërkuar me date 07.11.2023 OE ka ofruar si me poshtë

Front axle damping system shock absorber and airbags	Fitted
Rear axle damping system shock absorber and airbags	Fitted

Në katallogun e derguar te dates 07.11.2023 nuk deshmon qe sistemi i amortizimit duhet te jete me amortizator por vetem me ajer behet pezullimi andaj OE nuk e ploteson kete specifikacionet teknike te kerkuara ne Aneksin 1.

2. Pozicioni 17. Aneksi 1 Sistemi I frenimit: min ABS

Me date 19.10.2023 OE ka sjelle

Brake system	Full disk brake with Wabco EBS

Ndërsa me date 07.11.2023 OE ka ofruar

ABS / Anti-lock braking systems	Fitted

OE e prezanton si ABS e inkorporuar dhe bene ndryshimin nga EBS ne ABS

2. *Pozicioni 20*

Pajisjet standarde minimale; Xhamat e dyfishtë, perdet , fellne standarte, mbrojtëset nga dielli para, ulësja ndihmëse, radio CD, mikrofonin për informimin e pasagjerëve, drita për mjegull, tepihat e dyshemesë, paranxemje (vebstator),

Me date 19.10.2023 OE ka sjelle

Heat system	Passenger heat system with 4 Radiators

Do te thotë qe ne ofertën e tij ka ofruar mundësi te nxehjes me radiator po jo te paranxemjes ashtu siç është kërkuar ne Aneksin 1 specifikacionet teknike te detyrueshme ne kërkuara ne dosjen e tenderit.

Ndërsa me date 07.11.2023 OE ka ofruar

Pre-Heater	Fitted

Qe do te thotë sistemi i paranxemjes i inkorporuar

2. *Pozicioni 21*

Ne Aneksin 1 Autobusi duhet të jetë Turistik me Klimatizim

Me date 19.10.2023 OE ka sjelle

A/C	Sutruck AC

Ndërsa me date 07.11.2023 OE ka ofruar

Air-Condition	Fitted

Andaj grupi i OE konsiderohet i papërgjegjshëm pasi qe nuk i plotëson specifikacionet teknike te kërkuara ne dosjen e tenderit Aneksi 1 si dhe ka bere ndryshime materiale

konforme nenint 59.2 dhe refuzohet oferta si e pa përgjegjshme. Sipas nenit 59 pika 2 te LPP-se, Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. Andaj oferta juaj refuzohet pasi që kemi ndryshim materiali"

AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional, ndër të tjera ka përcaktuar kërkesën me numër rendor 1: "*Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar te karakteristikave teknike, me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikacioneve teknike ofruara.* Dëshmia dokumentare e kërkuar është përcaktuar: "*Dëshmia 1. Katalog nga prodhuesi*."

Më tej në Aneksin 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme janë përcaktuar 21 specifikime teknike.

OE ankues në ofertën e dorëzuar, ka dorëzuar dokumentin "Katalogu nga Prodhuesi". Në dokument prezantohet informacioni i prodhuesit "XIAMEN GOLDEN DRAGON BUS CO., LTD" Xiamen, China, me titull "SPECIFICATION", për modelin "Model Triumph serial XML6121J tourism version".

Poashtu OE ankues ka dorëzuar edhe dokumentin me emërtimin "Specifikacioni teknik" në të cilin janë paraqitur specifikimet teknike dhe dokumenti është nënshkruar dhe vulosur nga OE.

Me datë 03.11.2023, AK përmes e-prokurimit kishte dërguar OE ankues letrën standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit, në të cilin ndër të tjera kishte kërkuar "*Ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate është kërkuar kriteri; Kërkesa 1 - Katalog nga prodhuesi me përshkrim te detajuar te karakteristikave teknike, me te cilën është e mundur vlerësimi i specifikacioneve teknike ofruara. Dëshmia 1. Katalog nga prodhuesi. Ju keni dorëzuar broshure ju lutem na dërgoni katalogun te hijezuar-nënvizuar sipas specifikave te kërkuar ne aneksin I.*"

OE ankues me datë 08.11.2023 ka ngarkuar skedarin (fajllin) me emërtimin "Dokumentacioni shtese" në të cilin janë dërguar 5 dokumente.

Dokumenti me emërtimin " Annex 1 - Final Version" në të cilin është plotësuar tabela e aneksit 1 të dosjes së tenderit, e cila është e njëjtë me dokumentin "Specifikacioni teknik" të dorëzuar me ofertë, përveç në pozicionin 6, ku gjatësia shënon të jetë 12340 mm, për dallim nga dokumenti i dorëzuar me ofertë në të cilin shënohet gjatësia prej 13340 mm.

Dokument tjetër i dorëzuar është dokumenti "Deklaratë nga Prodhuesi", në të cilin prodhuesi deklaron ndër të tjera si vijon: "*3. Please Note: In the last Annex 1 document Line 6, there was an error typing 13340. Instead of this, it must be 12340. Please find attached the corrected and Final Annex 1 version*." (shqip: "*3.Ju lutemi vini re: Në dokumentin e fundit të Shtojcës 1, rreshti 6, kishte një gabim duke shkruar 13340. Në vend të kësaj, duhet të jetë 12340. Ju lutemi gjeni bashkangjitur versionin e korrigjuar dhe përfundimtar të Aneksit 1*").

Dokumenti tjetër i dorëzuar është katalogu me emërtimin "New Triumph Series Updated Version EURO VI" i prodhuesit Golden Dragon, Trump Luxury Bus Series, Në këtë dokument janë paraqitur imazhet e dy modeleve, ku është kufizuar me ngjyrë të verdhë njëri

nga dy modelet (kufizimi është bërë nga përdoruesi k.gërguri@landrover-ks.commе datë 08.11.2023). Në "metadatat" e dokumentit shënohet se dokumenti është krijuar me datë 08.03.2019 ndërsa është modifikuar me datë 08.11.2023.

Pas këtyre sqarimeve, AK me datë 22.11.2024, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe letrat standarde, ku OE ankues ishte vlerësuar si i papërgjegjshëm.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues me datë 27.11.2023 kishte dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në AK, përderisa AK me datë 01.12.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

OE ankues me datë 10.12.2023 kishte dorëzuar ankesë në OSHP, e regjistruar me numër të ankesës 10.12.2023.

OSHP me datë 17.04.2024 ka nxjerrë vendim përmes të cilit e aprovon pjesërisht ankesën e OE ankues.

Pas vendimit të OSHP-së, AK me datë 02.05.2024, përmes emailit kishte kërkuar informacione shtesë nga prodhuesi, përkatësisht kishte kërkuar katalogun e prodhuesit (jo broshurë) të modelit të autobusit XML6121J.

Prodhuesi me datë 07.05.2024 përmes emailit kishte dërguar 5 dokumente. Të njëjtat të cilat i kishte dërguar OE ankues me sqarimet e datës 08.11.2023, si dhe dy dokumente tjera. Dokumentin "Manufacturer Declaration 02" i datës 07.05.2024 ku shënohet: "*Ne, Golden Dragon Bus si Prodhues konfirmojmë se dokumentet e mëposhtme që keni kërkuar janë të VLEFSHME dhe ne mbështesim plotësisht Policinë e Kosovës përmes distributorit tonë FroHan ApS lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Ju lutemi gjeni bashkëngjitur dokumentet dhe me këtë ne konfirmojmë se autobusët do të prodhohen dhe furnizohen sipas Aneksit 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUARA. Doc 1: Seria e re e Triumf Versioni i përditësuar EURO VI.pdf, Doc 2: Konfirmimi i prodhuesit.pdf, Doc 3: Shtojca 1 - SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUARA, Doc 4: Letër sqaruese.pdf*." Gjithashtu prodhuesi kishte bashkangjitur dokumentin "Claridication Letter" në të cilin shënohet: "*Ne XIAMEN GOLDEN DRAGON BUS CO., LTD, të cilët janë zyrtarë prodhuesi i autobusit turistik të ofruar për projektin: Numri i Prokurimit: 214-23-10050-1-1-1, Titulli i prokurimit: FURNIZIM ME AUTOBUS PER POLICIN E KOSOVES-RITENDER. Ne konfirmojmë se versioni turistik i modelit XML6121l është me certifikatë miratimi të tipit të automjetit të plotë (WVTA) dhe do të bëhet sipas standardit evropian. Numri WVTA është: E4*2007/46*0121 *15*.*".

<u>Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 2</u>

Eksperti sqaron se bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit, OE duhej të dorëzonin katalogun nga prodhuesi për modelin e ofertuar me përshkrim të detajuar te karakteristikave teknike, me të cilën është e mundur vlerësimi i përmbushjes së specifikacioneve teknike. Katalogu i dorëzuar me ofertë nga OE ankues nuk përmbante të gjitha informatat për të vlerësuar përmbushjes e specifikimeve teknike të kërkuara në dosjen e tenderit. Krahas kësaj OE ankues nuk kishte shënuar të dhënat për specifikimet e ofertuara krahas specifikimit të kërkuara ashtu sikurse ishte kërkuar në tabelën e specifikimeve në aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Katalogu i dërguar me sqarime nga OE ankues dhe prodhuesi nuk paraqesin të njëjtin informacion sikurse katalogu i dorëzuar me ofertë. Duke filluar nga dimensionet ku është konfirmuar nga prodhuesi, modeli i autobusit të cilin OE dhe prodhuesi përmes sqarimeve e prezantojnë si modeli që do të prodhohet dhe liferohet është me i shkurtë 1,000mm (100cm apo 1metër) se modeli i prezantuar me ofertë.

Tutje, në lidhje me sistemin e frenimit, në dosjen e tenderit është kërkuar "*Sistemi i frenimit: min ABS*". Në katalogun e dorëzuar me ofertë, tek sistemi i frenimit shënohet se modeli i ofertuar ka sistemin "*full disk brake with Wabco EBS*" ndërsa tek katalogu i dorëzuar me sqarime shënohet se sistemi i frenimit është "*ABS/anti brake locking system – Fitted*". Eksperti në lidhje me këto dy sisteme të frenimit sqaron se ABS (Anti-lock Braking System) dhe EBS (Electronic Braking System) janë sisteme frenimi që përmirësojnë sigurinë dhe performancën e automjeteve. ABS, parandalon bllokimin e rrotave gjatë frenimit të fortë për të ruajtur drejtimin dhe kontrollin e automjetit. Në anën tjetër, EBS menaxhon frenimin në mënyrë elektronike, duke optimizuar shpërndarjen e forcës së frenimit dhe koordinuar me sisteme të tjera të sigurisë si ABS, ASR dhe ESP. Pra edhe në këtë rast OE kishte ndryshuar specifikimin e sistemit të frenimit nga "*Wabco EBS*" i prezantuar në katalogun me ofertë në "*ABS*" sipas katalogut të dërguar me sqarime.

Një element tjetër është edhe sistemi i drejtimit, ku në dosjen e tenderit ishte kërkuar "*Sistemi i drejtimit: Servo Hidraulik*". Në katalogun e dorëzuar me ofertë shënohet se sistemi i drejtimit është "*Bosch Power steering*", ndërsa në katalogun e dorëzuar me sqarime shënohet "*Servo Hydraulic system-Fitted*". Dy sistemet dallojnë në mekanizmin, komponentët dhe mënyrën e funksionimit. Pra, edhe në këtë kishte ndryshuar specifikimi teknik nga "*Bosch Power steering*", në "*Servo Hydraulic system*".

Tjetër, tek sistemi i amortizimit në dosje të tenderit është kërkuar "*Sistemi i amortizimit për aksin e parë duhet të jetë me amortizator, dhe jastak me ajër. Sistemi i amortizimit për aksin e pasëm duhet të jetë me amortizator, dhe jastak me ajër.*". Në katalogun e dorëzuar me ofertë shënohet: "*air suspension for all axles*" ndërsa në katalogun e dorëzuar me sqarime janë "*Front axle damping system shock absorber and airbags. Rear axle damping system shock absorber and airbags*". Eksperti sqaron se sistemi i ajrit për të gjitha akset përdor ajrin për të mbështetur ngarkesën, ndërsa sistemi i amortizatorëve të aksit dhe ajrit kombinon amortizatorët dhe ajrin për të përmirësuar për të menaxhuar ngarkesën në autobusë. Pra, edhe në këtë rast kishte ndryshuar specifikimi teknik i dërguar me ofertë nga ai i prezantuar në sqarime.

Krahas ndryshimeve të sipërpërmendura, është evidente se modeli i ofertuar nuk është i njëjtë me modelin e dërguar me sqarime i cili sipas OE dhe prodhuesit do të prodhohet dhe liferohet. Ndryshimet janë lehtësisht të dallueshme nëse krahasohen imazhet e autobusit nga të dy katalogët. Për me tepër edhe në katalogun e dorëzuar me sqarime ka dallime të autobusit të shënjuar (përcaktuar me drejtkëndësh me ngjyrë të verdhë në faqe 2 dhe 3) me autobusin e paraqitur në faqen 6. Në të dy anët e autobusit dallojnë numri i hapësirave për bagazh, në anën e majtë të autobusit, modeli i dorëzuar me ofertë dhe autobusit në faqe 6 të katalogut të dërguar me sqarime, në mes të dy rrotave ka një derë për bagazh, kurse modeli i prezantuar me sqarime në faqen 1, 2 dhe 3, ka 3 dyer rrjedhimisht 3 hapësira për bagazh.

Poashtu në të dy anët modeli i dorëzuar me ofertë dhe autobusit në faqe 6 të katalogut të dërguar me sqarime pas pjesës së dizajnit në formë harku deri në fund të autobusit ka 6 dritare, kurse modeli i autobusi i prezantuar me sqarime në faqen 1, 2 dhe 3 ka 7 dritare.

Më tej, në pjesën e djathtë, tek modeli i dorëzuar me ofertë dhe autobusit në faqe 6 të katalogut të dërguar me sqarime dera e autobusit është e vendosur pas rrotës së pasme. Ndërsa tek autobusi i prezantuar me sqarime (i kufizuar me të verdhë) në faqen 1, 2 dhe 3 dera është e vendosur në mes të

dy rrotave.

Si përfundim, Eksperti sqaron se OE ankues në ofertën e tij ka dorëzuar katalogun i cili nuk dëshmon përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit. Më tej, ashtu sikurse është sqaruar mësipër, në katalogun e dorëzuar me sqarime ka dallime të specifikimeve teknike në raport me katalogun e dorëzuar me ofertë, gjë që ky veprim është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 59 të LPP-së, andaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" Prishtina Auto " L.L.C.**

Kreshnik Spahiu